

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"STUDENT INC" SHPK**

Të angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare, në mbështetje të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, sot më datën 10/06/2021 shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1 Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do jetë "**Student Inc**", e quajtur më poshtë "Shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK"

2 Ortakët e shoqërisë

Ortakët e shoqërisë janë:

- a) Jona Shtini, e bija e Seidit dhe Mirelës, lindur në Tiranë më 23.05.2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Rr. "Shëngjergj", Kavajë, me ID K05523071A.
- b) Kristi Nene, i biri i Dhimitrit dhe Mamicës, lindur në Korçë më 14.05.2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Rr. "Niko Kovaci" lagjia 10, Korçë me ID K00514073H.
- c) Zhaklina Braka, e bija e Xhevairit dhe Afërditës, lindur në Fier më 1.12.1999, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Rr. "Neim Braka", Fier, me ID J96201089I.
- d) Besjan Çoku, i biri i Besnikut dhe Florinës, lindur në Lushnjë më 29.04.2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Bulevardin Zhan D'Ark 4, Brryl, Tiranë, me ID K00429018I.
- e) Armegi Mebelli, e bija e Artit dhe Klodianës, lindur në Lushnjë, më 17.03.2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Qytet Studenti, Rr.Pjeter Budi, Tiranë, me ID K05317021V.

3 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë ofrim shërbimesh zhvillim programesh, aplikacione, dizajn dhe konsulencë të lidhur me këto shërbime. Menaxhim projektsh.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me Vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4 Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5 Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë do të jetë: Rruga "Skënderbeg", 21/1, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë degë dhe /ose zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera tregtare dhe /ose të huaja. Këto mund të krijohen dhe të mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

6 Kapitali themeltar i shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është caktuar në masën 1,000 (njëmijë) lekë.

Kapitali themeltar ndahet në 5 (pesë) kuota:

- a) Ortaku, Jona Shtini, e cila zotëron 20% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuota, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
- b) Ortaku, Kristi Nene, i cili zotëron 20% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuota, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
- c) Ortaku, Zhaklina Braka, e cila zotëron 20% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuota, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
- d) Ortaku, Besjan Çoku, i cili zotëron 20% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuota, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
- e) Ortaku, Armegi Mebelli, e cila zotëron 20% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuota, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.

7 Organet vendimarrëse të shoqërisë

Organet vendimarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori i shoqërisë

8 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë realizohet me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Ortakët, me kërkesë të administratorit në mënyrë unanime dhe në përpjestim të drejtë të kuotave që posedojnë mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë

nëpërmjet rritjes së kapitalit, duke ruajtur normat e transparencës bankare dhe kërkesat e tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe financimeve të ortakëve mund të bëhen me vendim të Asamblesë së ortakëve.

9 Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Ortakët duhet të shesin kuotat e tyre menjëherë pas diplomimit të tyre në mënyrë të detyrueshme dhe në çdo rast kalimi i kuotave bëhet me kontratë me shkrim.

10 Organi vendimarrës

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u

dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

12 Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

13 Administrimi

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Mandati është i rinovueshëm.

Administratori i shoqërisë do të jetë Besjan Çoku, i biri i Besnikut dhe Florinës, lindur në Lushnjë më 29.04.2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në Bulevardin Zhan D'Ark 4, Brryl, Tiranë, me ID K00429018I.

14 Kompetencat e administratorëve

1. Administratorët kane të drejtë të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme në raste kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

15 Përgjegjësitë e administratorëve

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryerë gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratorët detyrohen:

- 1.a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanëjnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

16 Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbaron në 31 dhjetor.

17 Ekspertët

Expertit ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

18 Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të priset në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Në këtë rast Asambleja e ortakëve të shoqërisë merr vendim me shkrim me të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën "Shoqëri në likuidim e sipër".

Nese Asambleja e ortakëve të shoqërisë nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

19 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

20 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT E SHOQËRISË "STUDENT INC"


Jona Shtini



Kristi Nene



Zhaklina Braka



Besjan Çoku



Armegi Mebelli

